



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet në parim Nisma për "Amendamentimin e Traktatit Bazë të Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP).
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*për*  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-215 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë me Letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor, Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt, vendimit të Qeverisë Nr. 15/158 të datës 29 nëntor 2013, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shtetasit e Bosnjës dhe Hercegovinës, mbështetur në dispozitat e Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë me Letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor, nga data 1 janar 2025, lirohen nga regjimi i vizave për hyrje, transit dhe qëndrim afatshkurtër në territorin e Republikës së Kosovës jo më shumë se 90 ditë në çdo periudhë 180 ditore që përfshin marrjen në konsideratë të 180 ditëve para çdo ditë qëndrimi, me letërnjoftim biometrik valid.
2. Ndryshohet dhe plotësohet Shtojca I, e përcaktuar në pikën 1. të vendimit të Qeverisë Nr. 15/158 të datës 29 nëntor 2013, duke listuar Bosnjën dhe Hercegovinën në listën e vendeve të cilat lirohen nga regjimi i vizave për hyrje, transit dhe qëndrim afatshkurtër në territorin e Republikës së Kosovës deri në 90 ditë për një periudhë gjashtë (6) mujore me letërnjoftim biometrik valid.
3. Pikat e tjera të vendimit Nr. 15/158 të datës 29 nëntor 2013/mbesin në fuqi.
4. Obligohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit, Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Impianti për Trajtim të Ujërave të Zeza në Podujevë.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

- Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit, Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Efiçenca e Energjisë në Ndërtesa Publike".
- Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

*PËR*  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 30 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 15 paragrafit I të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për transfer të mjeteve buxhetore në shumë prej nëntëqindëzvetetë mijë e shtatëqindëzvet euro (948,740€), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të kategorisë së Investimeve kapitale të nën programit Arritjet Sportive, me kod 80200, për mbulimin faturave dhe obligimeve kontraktuale.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207, nga kategoria e shpenzimeve "Investimeve Kapitale" nga nën-programi Arritjet Sportive, me kod 80200, nga projekti "Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Pejë" me kod 14553, në shumë prej 948,740€ (nëntëqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e dyzet euro), transferi është -23.33% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nën programit (duke përfshirë të gjitha transferet e realizuara në këtë nën program gjatë vitit 2024).
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi transferohen në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në nën-programet, si në vijim:
  - 3.1. Administrata Qendrore, me kod 11307, në shumë prej 200,000 € (dyqind mijë euro);
  - 3.2. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, me kod 12500, në shumë prej 10,000 € (dhjetë mijë euro);
  - 3.3. Sportet e Gjëra, me kod 80100, në shumë prej 20,000 € (njëzetmijë euro);
  - 3.4. Përkrahja e Kulturës, me kod 80500, në shumë prej 80,000 € (tetëdhjetë mijë euro);
  - 3.5. Mbrojtja Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore, me kod 81500, në shumë prej 135,000 € (njëqind e tridhjetë e pesë mijë euro);
  - 3.6. Galeria Kombëtare e Kosovës, me kod 82000, në shumë prej 100,000 € (njëqind mijë euro);
  - 3.7. Baleti Kombëtar i Kosovës, me kod 82100, në shumë prej 86,405 € (tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesë euro);
  - 3.8. Divizioni për Promovimin e të drejtës së autorit, me kod 82200, në shumë prej 33,751 € (tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një euro);
  - 3.9. Instituti Arkeologjik i Kosovës, me kod 82300, në shumë prej 153,584 € (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër euro);
  - 3.10. Muzeu i Kosovës, me kod 82400, në shumë prej 80,000 € (tetëdhjetë mijë euro);

- 3.11. Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, me kod 82500, në shumë prej 20,000 € (njëzet mijë euro);
- 3.12. Opera e Kosovës, me kod 82600, në shumë prej 30,000 € (tridhjetë mijë euro).
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

*PËR*   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 62, paragrafit 4. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L063 dhe me Ligjin 05/L-007, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Zubin Potokut për aprovimin e Buxhetit pas miratimit të Buxhetit për vitin 2025 nga Kuvendi Komunal.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me tabelat t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komuna e Zubin Potokut për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Tu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 16, paragrafit 3. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për rialokimin e mjeteve në shumë prej trembëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent, (13,395,394.60€) deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nën programit Forca e Sigurisë së Kosovës, me kod 36000 për vitin 2024, nga kategoria e shpenzimeve e investimeve kapitale.
  2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga Ministria e Mbrojtjes me kod 217, nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale" në kuadër të nën programit Forca e Sigurisë së Kosovës, me kod 36000, rialokimi është -24.60% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nën programit Forca e Sigurisë së Kosovës, me kod 36000 (duke përfshirë të gjitha rialokimet e realizuara në këtë nën program gjatë vitit 2024), nga projektet si në vijim:
    - 2.1. Automjete dhe Kamion, me kod 19073, në shumë prej -10,061,120€ (dhjetë milionë e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e njëzet euro);
    - 2.2. Ndërtime dhe Renovime, me kod 19071, në shumë prej -3,156,266.24€ (tre milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e njëzet e katër cent);
    - 2.3. Pajisje tjera, me kod 11123, në shumë prej -131,082.51€ (njëqind e tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë e një cent);
    - 2.4. Kompjuter, me kod 15587, në shumë prej -36,166.65€ (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e pesë cent);
    - 2.5. Sistemet dhe Pajisjet e Komunikimit, me kod 18806, në shumë prej -10,759.20€ (dhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent).
  3. Mjetet nga pika 2. e këtij Vendimi rialokohen në projektin "Sisteme, pajisje dhe artikuj për mbrojtje" me kod 19072, në shumë prej trembëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent (13,395,394.60€)
  4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mbrojtjes, për zbatimin e këtij vendimi.



5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

*PK*



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 30 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 15 paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për transfer të mjeteve buxhetore në shumë prej një milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë euro (1,850,000€), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të kategorisë së shpenzimeve "Investimeve Kapitale" të nën programit "Ndërtimi i Autostradave", me kod 42200, për mbulimin obligimeve të shpronësimit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, nga nën-programi "Ndërtimi i Autostradave", me kod 42200, nga kategoria e shpenzimeve "Investimeve Kapitale", nga projekti "Rruga Nacionale Prishtinë-Gjilan-Konqul" me kod 15090, në shumë prej 1,850,000€ (një milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë euro) transferi është -24.77% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nën programit (duke përfshirë të gjitha transferet e realizuara në këtë nën program gjatë vitit 2024).
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi transferohen në nën programin "Zyra për Shpronësim" me kod 60500, në kategorinë e shpenzimeve "Investimet Kapitale" në projektin "Shpronësimet" me kod 13130.
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për zbatimin e këtij vendimi.



5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

*PëK*  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/237  
Datë: 12.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22, paragrafit 3. të Ligjit Nr. 08/1--258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, nenin 14, paragrafët 1.7 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/ L-137 për Pyjet, nenit 13, paragrafit 2 dhe nenin 17, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/ L-125 për Pronën Publike, nenit 21, paragrafët 1.1 dhe 1.3. të Ligjit Nr. 06/ L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr.17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2024, merr këtë

**V E N D I M**

1. Institucionet e Republikës së Kosovës mund të japin me qira ose në shfrytëzim pronat publike për ndërtimin e kapaciteteve të reja të energjisë nga burimet e ripërtërishme vetëm bazuar në një proces të ofertimit konkurrues të organizuar nga Ministria e Ekonomisë.
2. Procesi i ofertimit konkurrues i organizuar nga Ministria e Ekonomisë me procedurë transparente, jodiskriminuese dhe konkurruese, konsiderohet rast i veçantë në interes të përgjithshëm publik.
3. Ofertuesit e kualifikuar në procesin e ofertimit konkurrues obligohen të paraqesin kërkesë për pëlqim paraprak për marrje me qira ose në shfrytëzim të pronave publike të Agjencisë Pyjore të Kosovës ose të komunave.
4. Kërkesa e ofertuesve të kualifikuar përbajnë të dhëna rreth projektit të tyre dhe konfirmimin se kanë vendosur matës të erës për një periudhë prej të paktën gjashtë (6) muajsh, nëse është e aplikueshme.
5. Institucioni përkatës, brenda dyzet e pesë (45) ditëve kalendarike, lëshon pëlqimin paraprak që konfirmon disponueshmërinë e pronave të kërkuara, dhe nuk merr parasysh kërkesa të tjera përveç të ofertuesve të kualifikuar.
6. Pas përfundimit të procesit të ofertimit konkurrues, ofertuesi ose ofertuesit fitues duhet të paraqesin kërkesë në institucionin përkatës për marrjen me qira ose në shfrytëzim pronën publike. Kjo kërkesë trajtohet si kërkesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Ekonomisë.
7. Pronat publike do të jepen me qira ose në shfrytëzim vetëm për ofertuesin ose ofertuesit e suksesshëm, duke u bazuar në pikën 2. të këtij vendimi.



8. Dhënia me qira ose shfrytëzimi i pronave publike bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 14 paragrafët 1.7 dhe 4, të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet dhe nenit 21, paragrafët 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe sipas dokumentacionit përkatës të procesit të ofertimit konkurrues.
9. Vlera e qerasë caktohet nga institucioni përkatës dhe duhet të reflektoj vlerën e tregut, merr parasysh lokacionin dhe rastet e ngjashme paraprake.
10. Kur pronat publike të referuara në këtë Vendim janë toka bujqësore sipas Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, ato duhet të jenë të klasës pesë (5) e tutje.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

*PËR*   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë